



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

**PROCESVERBALI I MBAJTJES SË MBLEDHJES KONSTITUIVE TË KKSB PËR VITIN
2018**

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i panit të veprimit dhe dinamikes te KKSB-së ;
2. Informatë lidhur me gjendjen e sigurisë në komunën e Prishtinës;
3. Te ndryshme;

Selim Pacolli nënkyrjetar i Komunës e hapi mbledhjen duke i përshëndet të pranishmit, dhe i njoftojë me rendin e ditës.

Pika e parë - u miratua plani i veprimit dhe dinamika e punës të KKSB-së nga të pranishmit.

Pika e dytë - gjendja e sigurisë në Komunën e Prishtinës.

Shkelzen Gjafa - komandat i stacionit policor qendra i cili tha: sa i përket zonës së sigurisë e vlerësojmë të qetë , duke vlerësuar edhe bashkëpunimin e ngushte me të gjithë akterët e sigurise . Sa i përket prishjes së rendit dhe qetësisë publike ka pasur një rritje në krashtë me vitin paraprak te periudhës së njëjtë me 186%.Kërkojë bashkëpunim më të madh me Inspeksionin Komunal gjatë shqiptimit të kundërvajtjeve ne teren, që te ketë më shume shqiptime te gjobave për Gjykatë. Policia e Kosovës në rast kundërvajtje të trafikut prej tanë do të behet pagesa në vendngjarje.

Ka pas rritje të gjobave me 2% , po ashtu rrëth pikave të komunikacionit shtoj se për shkak të kalimit të kontratës së kompanisë për tërheqjen e veturave "Merimangë" po ka shume pritje për tërheqjen e automjeteve gjerë në dy orë vonesë ,shqiptimi i gjobave të kësaj natyre është 27.99%, Sa i përket masave preventive për vetëdijesimin e të rinjve kundër përdorimit të drogës dhe delikuencave tjera kemi një rritje prej 97% prej moshave madhore e gjerë te ato të reja apo adoleshent. Te rastet e vjedhjeve kemi ulje të lehtë të tyre .

Gjithjashtu shqetësuese e vlersoje gjendjen e sigurise në pjesën e Kampusit universitar, ku rrëth 59 mijë njerëz e frekuentojnë çdo ditë , ndërsa në periudhën e mbrëmjes ku vende-vende nuk ka ndriçim të mire po ndodhin vepra të vjedhjeve dhe të tjera të ndryshme , në vendet ku ka ndriçim të mirë ka masa përmirësuese. Kemi pas edhe takime me Ministrin e Arsimit për të përmirësuar gjendjen e sigurisë në atë pjesë.

Selim Pacolli nënkyrjetar i Komunes e pyeti komandantin e policisë për grup moshat që janë përdorues të drogës.

Faqe 1 nga 4

Shkelzen Gjafa tha se janë të përfshira moshat prej 18-22 vjeqare , por qe nga mosha 14 vjeqare fillon kjo dukuri. Gjithashtu ai propozoj që përmes Drejtorisë se Arsimit dhe të bashkëpunimit me shkollat dhe me këshillin e prindërve të merren masa preventive për këtë dukuri, ndërsa sa i përket masave ndëshkuese të marra nga policia janë shumë të vogla për shkak se janë adoleshent. Shqetësimet e ndryshme i marrim në mbledhjet e forumit të KLSP se lagjes me te cilët kemi bashkëpunim të mirë.

Gani Berisha- Komandanti stacionit policor te jugut tha se; po ka shumë shqetesime të qytetreve për prishjen e rendit dhe qetësisë nga zhurma e kafiterive, ai përmendi me theks te veçantë rastin në lagjen Dardania të kafiterisë " Monako", ku propozoj që së bashku me inspektionin komunal ta hartojnë një planë veprimi për këtë çështje sepse në të kunderten do të kemi pasoja të mëdha. Shqetësuese është edhe dukuria e vjedhjeve të rënda . Gjithashtu ai theksoj edhe dukurinë e përdorimit te drogës nëpër shkollat tona shumë shqetësuese për të gjitha stacionet policore të Komunës së Prishtinës .

Safet Jashari- Komandanti i stacionit policor të veriut thotë se takimet e KLSP do te jenë shumë të nevojshme duke u bazuar në atë se kjo pjesë është një zonë e gjerë që përfshin 70 fshatra, si dhe pjesën urbane. Raportet e sigurisë janë në nivel të mirë dhe përfshijnë etnitete të ndryshme ku për një kohë të gjatë nuk kemi pasur asnje ekses ndër nacional por atje është një situate shumë e qetë, mbahen mbledhjet e KKSBB-se. Kjo zonë ka të formuara dy KLSP, njëra në Bardhosh dhe tjetra ne malësinë e Gollakut konkretisht në fshatin Keqekollë, ku përfshihen fshati Mramuer dhe Marec.

Gjatë takimeve të mbajtura kanë dalë disa shqetësime të qytetarëve dhe do ti përmend disa nga to, duke përfshirë periudhën 6 (gjashtë) mujore deri më sot, rrøl të rëndësishëm luan edhe transporti publik, të jetë të pakten 4 herë në ditë për fshatrat e largëta të Gollakut. Ka pas protesta nga operatorët e linjave edhe lidhur me operimin e taksive ilegalë në linjen Prishtine - Podujeve, ku kemi kërkuar një bashkëpunim me Inspektionin komunal për të larguar taksitë ilegalë.

Protest tjetër është ajo e banorëve të Marecit lidhur me çështjen e sigurisë, sidomos në afërsi të shkollës. Kemi pasur takim me banorët e zonës në fshatin Llukar ku kanë potencuar nënkalimin jo funksional në Bardhosh. Protesta tjetër e banorëve të fshatit Keqekollë ku kanë kundërshtuar pagesën e mbeturinave me pretekst se nuk po ka investime në infrastruktur dhe kanë kërkuar largimin e deponive ilegale të mbeturinave rrëth rrugës kryesore, gjithashtu bunarët e hapur, paraqesin rezik të madh, ku kanë rënë bagëti.

Problem tjetër është edhe qendra rekreative-sportive shumë e demoluar dhe jo funksionale për aktivitete , gjithashtu shqetësuese është edhe pjesa te fshati Siqevë te gurëthyesi, ku ka rrezik të shembjes se asaj pjese, ku edhe telat e rrymës kanë rënë në tokë dhe mund te këtë ndonjë pasoje për qytetarët . Policia e Kosovës ka një zyre te kufirit ku vëzhgon këtë rajon te gjerë , por është kërkuesë e qytetareve të futen në funksion zyret e vendit në fshatrat Mramuer dhe Slivovë.

Ndërsa sa i përket gjendjes infrastrukturore të qendrës policore të veriut është e mjerushme, jemi në kontakt me komunën ku kemi identifikuar disa parcela ku mund te ndertohet stacioni i ri, dhe ka pasur procedura të stërgjata si në gjykatë dhe AKP-në.

Selim Pacolli -pyeti komandantin: si është gjendja e sigurisë në zonën kufitare ku ajo pjesë përfshinë një zonë të gjerë.

Safet Jashari gjendja është e mirë, me përjashtim të ekseseve të vogla rrëth vjedhjeve të bagëtive .

Adonis Tahiri kemi pas një takim me Inspektionin për ti kontrolluar linjat e transportit publik, por nuk ka staf të mjaftueshëm.

Lulzim Shehu përfaqësues fetar i Tarikateve. Kemi pasur 5 objekte fetare në të cilat zhvilloheshin rite fetare të këtij besimi. Jam i kënaqur por jo aq me çështje të sigurisë, kërkjojë që në objekte fetare të ketë siguri më të madhe, ndriçimi është mirë pore të i jepet një prioritet më i lartë.

Ilmi Uka përfaqësues i KLSP-së Keqekollë: tha se jam nga fshati Prapashticë ku është pika me e afërt me kufirin e Serbisë, neve nuk na lejohet si qytetet qe te kalojmë pa problem në pjesën tjetër të kufirit, ku fshatarët kanë arat e tyre. Nuk mund të mbjellin apo ti punojnë tokat e tyre në brezin kufitarë, ndërsa qytetarëve serbë ju lejohet punimi i arave si dhe marrja e bagëtive në anën tonë të kufirit. Po e theksojë se neve nuk na lejohet qasje në pronë ose marrja e bagëtive në anën tjetër të kufirit. Nuk ka bashkëpunim të ndërsjellë.

Ka pas protesta te fshatarëve në Keqekollë ku në mënyrë refuzuese nuk kanë lejuar kryrjen e punëve të Kompanisë pastrimi rrëth kryerjes se shërbimit. Duke refuzuar pagesën e mbeturinave me arsyetim se nuk është bërë investim në Infrastrukturën e kësaj ane tash e 5 vite. Kërkjmë një linjë të transportit publik për keto fshatra të largëta dhe ende nuk është realizuar kjo kërkësë e qytetarëve. Në ato fshatra të largëta jetojnë në varfëri dhe duhet të udhëtojnë me automjetet e tyre private. Dukuri shqetësuese është braktisja e arsimit, sidomos te femrat, kemi bërë kërkësë në komunë përmes përfaqësuesit të shkollës së Prapashticës për linje të autobusit, po ashtu kanë kërkuar sigurim fizik në shkollë dhe përfaqësuesi i lagjes kërkon që të hyjnë në prioritet të komunës këto kërkesa të qytetareve.

Hatem Kupina në cilësinë e kryesuesit të komiteit të KLSP-së, prpozoj që duke u bazuar në atë se kanë të dhënat e duhura për gjendjen e sigurisë, ai prpozoj që së pari të raportojnë KLSP-të, sepse ata i kanë të dhënat e dorës së parë dhe janë të emëruar në ato forume për të përcjellë brengat e qytetarëve. Policia të jetë me efikase dhe se këshilli te ketë rregullat e veprimit.

Selim Pacolli- rroli jonë është evidentimi i dukurive që cenojnë sigurinë dhe te gjitha ato duhet të futen në planin strategjik dhe pastaj te hartojmë planin e veprimit.

Hatem Kupina ngriti çështjen e qenve endacak, pastaj shenjëzimi i rrugëve varësisht ciles drejtori i perkasin. Drejtoria e Arsimit te kete planprogram qe në shkollat tona të ketë psikolog që të punojnë me fëmijë në parandalimin e narkomanisë, duke përgatitur Udhëzues për plan konkret që ndikon në renjen e kësaj dukurie shumë të dëmshme përrinë.

Violeta Hasani kryesuese e KLSP-se Qendra; ajo falënderoj Komunën e Prishtines për bashkëpunim si dhe policinë që na përkrahin për zgjidhjen e shumë problemeve të qytetarëve .

Gani Berisha paraqiti disa shqetësime që ndikojnë në sigurinë e qytetareve, si vendosja e kamerave në disa pjesë ku janë pika te zeza, qentë endacak , puna e kafiterive jashtë orarit.

Te ndryshme:

Hatem Kupina propozoj që për të qenë ky këshill me efikas të ketë të ftuar edhe drejtor tjerë të komunës, si shembull mori Drejtorinë e Drejtorisë për investime kapitale dhe menaxhim të kontratave të na pranojë në zyrën e tij për të adresuar problemet. Pastaj DSHPMSH te përgatit pikat më shqetësuese të veprimit në bashkëpunim edhe me policinë të ketë hapa konkret.

Ismail Kokaj Drejtor i DSHPMSH tha se plani i veprimit për qenët endacak është ngritur në nivel qendror , komuna do të bëjë trajtimin e tyre brenda ligjit .

Hetem Kupina Plani strategjik të dalë nga KLSP dhe i bazuar edhe në vërejtjet e policisë.

Ismail Kokaj brenda kësaj mbledhje do të jetë plani i veprimit dhe plani strategjik.

Gani Berisha stacioni policor jugu; prpozoj që të dy planet, ai i veprimit dhe ai operativ të dalin të kryera nga kjo mbledhje.

Safet Jashari stacioni policor veriu; e ngiti edhe një herë çështjen e caktimit të parcelës ta përcaktojë komuna per ndertimin e stacionit policor . Te shikohet se ku ka mbetur lënda, sepse kemi informata te ndryshme si nga gjykata po ashu edhe nga AKP-ja, se parcela e cekur nuk është identifikuar mirë. Është koha e fundit që të zgjidhet problemi i parcelës, duke u bazuar në atë se hapësirat publike janë pronë e komunës sipas ligjit. Është një hapësire e mjaftueshme diku rreth 20 ari truall e cila do ti perbushte nevojat tona si stacion policor, ndersa aspekti buxhetor për ndërtim është në MPB.

Violeta Hasni KLSP-Qendra paraqiti problemin që po shkaktojnë kafiterit në qendër me muzike "live" -të gjallë dhe po shkaktojnë zhurmë të madhe ku qytetaret nuk po mund të jetojnë një jetë normale.

Selim Pacolli - nënkyrytar; tha së bashku me Kryetarin kanë dalë në shesh dhe kanë biseduar me pronarët e lokaleve për orarin e kafiterive, edhe ata patën ankesa se ne po mbajmë familje. Besoj se do te arrijmë një marrëveshje mirëkuptimi të dyanshme.

Procesmbajtsja

Hateme Gashi

Kryesuesi i Mbledhjes së KKSB-së

Shpend Ahmeti



Faqe 4 nga 4

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë

Telefon: + 381(0)38/230-900

<http://www.prishtina-komuna.org>